



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional ,Udhëzimin Administrativ nr. 22/2013 Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës si dhe në bazë të Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovë për drejtimet e Gjinnazit - Drejtoria e Arsimit më datë 09.07.2024 shpallë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE
DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Për: Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Gjakovës

Përmes: znj.Eranda Baçi – Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit -Gjakovë



Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e certifikatave apo dëftesave në MASHTI, dhe më pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Çertifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën **10,11 dhe 12 Korrik 2024** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **13.07.2024**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **15.07.2024**.

Nxënësi i pakënaqur i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda **dy (2) ditë pune**, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t' i plotësojë këto kriteret:

| | | |
|---|---------|----------|
| 1. Suksesit nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesit nga lëndët nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |
| Nxënësi maksimalisht mund t' i fitojë | (100%) | 100 pikë |

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesit për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4.00 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9) pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesit i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t' i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është :

$$\text{Suksesit}(kl.6+kl.7+kl.8+kl.9) \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

- Nxënësi nga suksesit i përgjithshëm lëndëve prioritare, maksimalisht mund t' i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)} + \text{mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$$

- Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

a. Gjimnazi shkencave natyrore : Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë;

b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi;

- **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP :**
 - a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari :**
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi;
 - b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi - Teknologji, PTT:**
Matematikë , TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi;
 - c. **Ekonomi , Administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi ;
 - d. **Juridik dhe Administratë :**
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi ;
 - e. **Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi ;
 - f. **Shkollat Artistike :**
Gjuhë amtare dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë;

Drejtimi pedagogjik-profil bashkëpunëtor muzikor :

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl.IX) dhe Testin Kombëtar.

Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX-të) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII-të), në klasën e VII-të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e X-të - duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

II. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët Fizikë, Kimi dhe Biologji),

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Matematikë)}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (40 pikë nga lëndët Gjuhë shqipe, Gjuhë Angleze, Histori dhe Gjeografi)

$$\frac{mes(Gjuhë shqipe) + mes(Gjuhë angleze) + mes(Histori) + mes(Gjeografi)}{4} \geq 4$$

- **Shkollat e Shëndetësisë** - Mesatarja e lëndëve: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët Fizikë, Kimi dhe Biologji),

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë shqipe)}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit- numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

| | |
|------------------|----------------|
| I. Gjuhë : | |
| 1. Gjuhë shqipe | 35 pikë |
| 2. Gjuhë angleze | <u>15 pikë</u> |
| Gjithsejt ... | 50 pikë |

| | |
|--------------------------|----------------|
| II. Shkencat shoqërore : | |
| 1. Gjeografi | 25 pikë |
| 2. Histori | <u>25 pikë</u> |
| Gjithsejt ... | 50 pikë |

| | |
|-------------------|----------------|
| III. Matematikë : | |
| 1. Matematikë | 35 pikë |
| 2. Informatikë | <u>15 pikë</u> |
| Gjithsejt ... | 50 pikë |

| | |
|------------------------|----------------|
| IV. Shkencat natyrore: | |
| 1. Fizikë | 17 pikë |
| 2. Kimi | 16 pikë |
| 3. Biologji | <u>17 pikë</u> |
| Gjithsejt ... | 50 pikë |

4. Renditja e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të Gjinnazeve:

I. Gjinnazi shkencat e natyrës:

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

II. Gjinnazi shoqëror dhe gjuhësor:

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

5. Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në IAAP:

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehtari, gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion,

Komunikacion, Kimi, Teknologji

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca natyrore 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = | 40 pikë |

III .Ekonomi

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca shoqërore 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat natyrore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = | 40 pikë |

IV. Juridik

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = | 40 pikë |

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = | 40 pikë |

VI. Shkollat Artistike

| | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| Totali = | 40 pikë |

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik- profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII);

Në klasën e VII-të të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e X-të - duhet ti nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

REGJISTRIMI I NXËNËSVE NË KL.X-ta PËR TË GJITHA SHKOLLAT GJIMNAZE DHE INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP) PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025, është si në vijim:

I.- Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë

| Nr. | Shkolla | Drejtimet | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve | Vitet e shkollimit |
|--------------------|---|-----------------------------|------------------|----------------|--------------------|
| 1. | Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë | Shoqëror-gjuhësor | 5 | 5x30=150 | 3 vite |
| | | Shkenca natyrore | 9 | 9x30=270 | 3 vite |
| | | Gjithsejt : | 14 | 420 | |
| 2. | Gjimnazi “Hajdar Dushi ” paralelja e ndarë në Cërmjan | Shkenca shoqërore-gjuhësore | 1 | 30 | 3 vite |
| Gjithsejt : | | | 15 | 450 | |

II.- Në Gjimnazin “Asllan Berisha” në Rogovë

| Nr. | Drejtimet | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve | Vitet e shkollimit |
|--------------------|-------------------|------------------|----------------|--------------------|
| 1. | Shoqëror-gjuhësor | 1 | 32 | 3 vite |
| 2. | Shkenca natyrore | 1 | 32 | 3 vite |
| Gjithsejt : | | 2 | 64 | |

I . Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë

| Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr. paral | Nr.nx. |
|-------------------|------------------------|--|-----------|------------|
| "Hysni Zajmi" | Shëndeti dhe mirëqenia | Bashkëpunëtor profesional i infermierisë | 5 | 140 |
| | | Teknik i dhembeve | 1 | 28 |
| | | Teknik i farmacisë | 1 | 28 |
| | | Infermier i pediatriisë | 1 | 28 |
| | | Teknik i fizioterapisë | 1 | 28 |
| | | Teknik i laboratorit mjekësor | 1 | 28 |
| Paralelja Junik | | Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë (Paralelja e ndarë në Rogovë) | 1 | 28 |
| Paralelja Rogovë | | Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë (Paralelja e ndarë në Junik) | 1 | 28 |
| Gjithsejt: | | | 12 | 336 |

II.- Shkolla e Mesme e Lartë Teknike “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë

| Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr. paral. | Nr.nx. |
|--------------------|---|-------------------------------|------------|------------|
| "Nexhmedin Nixha" | Makineri, Elektroteknikë, Ndërtimtari dhe Arkitekturë | Operator prodhimi | 1 | 25 |
| | | Automekanik | 1 | 28 |
| | | Transport rrugor | 1 | 25 |
| | | Energjetikë | 1 | 25 |
| | | Instalues elektrik | 1 | 28 |
| | | Ndërtimtari | 1 | 25 |
| | | Arkitekturë | 1 | 25 |
| | | Informatikë | 2 | 40 |
| | Tekstil | Rrobaqepësi | 1 | 28 |
| | Art Pamor | Dizajn i tekstit dhe veshjeve | 2 | 40 |
| Gjithsejt : | | | 12 | 289 |

III.- Shkolla e Mesme e Lartë Ekonomike “Kadri Kusari” në Gjakovë

| Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr.i parale. | Nr.i nx. |
|----------------|------------------------------|--|--------------|-----------|
| "Kadri Kusari" | Ekonomi dhe juridik | Kontabilitet dhe tatime | 1 | 25 |
| | | Banka financa dhe sigurime | 2 | 50 |
| | | Shpedicion dhe logjistikë | 1 | 25 |
| | | Marketing dhe shitje | 1 | 25 |
| | | Tregti me pakicë dhe shumicë (Mësim dual) | 1 | 25 |
| | | Administratë dhe shërbime të zyrës | 2 | 50 |
| | Bujqësi Teknologji ushqimore | Prodhues i kulturave të përziera dhe të kafshëve | 1 | 25 |
| | | Përpunues i prodhimeve ushqimore | 1 | 25 |
| | Hoteleri dhe turizëm | Asistent I mikpritjes hoteliere (Mësim dual) | 1 | 25 |
| | Gjithsejt: | | | 11 |

IV. Shkolla e Mesme e Lartë e Muzikës “Prenk Jakova” në Gjakovë

| Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr.i paral. | Nr.i nxën. |
|-------------------|----------|--|-------------|------------|
| "Prenk Jakova" | Art | Bashkëpunëtor i përgjithshëm në muzikë | 1 | 15 |
| | | Interpret muzikor | 1 | 5 |
| Gjithsejt: | | | 2 | 20 |

Respekt!